



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:044517
Datë: 17.05.2024
Numri i dokumentit: 05702320

AA.nr.525/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditëses, Komuna e Mamushës, të cilën me autorizim e përfaqëson, G.G, në cilësinë e Udhëheqësit të Sektorit të Prokurimit, kundër të paditurit, Organi Shqyrtues i Prokurimit me seli në Prishtinë, të cilin me autorizim e përfaqëson, E.P, për shkak të anulimit të vendimit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.741/20, të datës;24.03.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;13.05.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të paditëses, Komuna e Mamushës, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.741/20, i datës;24.03.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, nën shenjën A.nr.741/20, të datës;24.03.2023, është vendosur, “*I. Refuzohet kërkesëpadia e paditëses, Komuna e Mamushës, me të cilën ka kërkuar që të anulohen pikat III, IV dhe V të vendimit, nr. 57/2020, i datës 03.03.2020, i protokolluar me nr.57/20 i datës 11.03.2020, i të paditurit, Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe të detyrohet e paditura t’ia kompensojë dëmin financiarë të shkaktuar, si e pa bazuar. II. Shpenzimet procedurale i bartë veç e veç secila palë në procedurë.*”

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësja, për shkak konstatimit të gabuar dhe jo të plotë gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e paditëses të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimi A.nr.741/20, i datës;24.03.2023, i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të ndryshohet ose të priset dhe çështja ti kthehet në rigjykim Gjykatës së shkallës së parë.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 paragrafi d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe ka gjetur se ankesa e paditëses është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë:30.03.2020, kundër vendimit të paditurës, Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), me nr. 57/2020 për pikat III, IV dhe V, të datës;03.03.2020, sepse konsideron që OSHP-ja me vendimin e kundërshtuar me padi ka bërë vërtetim të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe për shkak të shqiptimit të gjobës dhe presionit që të shpërblehet me kontratë një operator ekonomik i pa ndërgjegjshëm dhe ka shkelur të drejtën ligjore të Autoritetit Kontraktues si dhe e ka dëmtuar duke shqiptuar gjobë edhe përkundër se i kanë zbatuar në tërësi vendimet dhe urdhëresat e panelit shqyrtues të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditëses të paraqitur kundër të paditurit, dhe administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar, me të cilin kërkesëpadinë e paditëses e refuzon si të pa bazuar, me arsyetim se *“Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, ku ka gjetur se kërkesëpadija e paditëses është e pa bazuar. Komuna e Mamushës-Zyra e Prokurimit si Autoritet Kontraktues, me datë 24.05.2019, ka shpallur tenderin me titull: Furnizimi me fshesa për pastrim dhe vegla pune”. I pa kënaqur me vlerësimin e tenderit ankuesi “Comet” SH.P.K me datë 25.07.2019 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, ku me të njëjtën datë Autoriteti Kontraktues-Komuna e Mamushës ka marrë vendim me të cilin ia ka refuzuar kërkesën ankuesit. I pa kënaqur me vendimin e tillë O.E “Comet” Sh.P.K me datë 07.08.2019 parashtron pranë OSHP-se ankesën me nr.491-19 e datës 07.05.2019. Me datë 23.09.2019 Paneli Shqyrtues i OSHP nxjerrë vendim PSH.nr.491/19 me të cilin në dispozitivin I aprovon pjesërisht të bazuar ankesën e O.E “Comet” SHPK dhe në pikën II anulon vendimin për dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues që në afat prej 10 ditësh ta informojë me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra. Autoriteti Kontraktues Komuna e Mamushës me datë 26.09.2019, nxjerrë vendim 02.nr.177-19 me të cilin e anulon vendimin për dhënien e kontratës dhe lëndën e kthen në rivlerësim. Me datë 24.10.2019 Komuna e Mamushës ka pranuar akt përcjellësin-Mendimin e ekspertit shqyrtues në lidhje me ankesën e parashtruar nga Operatori Ekonomik nr.704/19 i cili ka konstatuar se Komuna e Mamushës nuk e ka zbatuar vendimin e OSHP-se PSH.nr.491/19 të datës 23.09.2018 dhe i propozon panelit shqyrtues që ankesa e O.E “Comet” Sh.p.k të pranohet dhe rekomandon Autoritetin Kontraktues që lëndën ta kthejë në rivlerësim. Me datë 28.10.2019 Komuna e Mamushës ka nxjerrë vendimin 02.nr.195-19 me të cilin e ka kundërshtuar mendimin e ekspertit shqyrtues. Me datë 17.12.2019 OSHP ka nxjerrë urdhëresën PSH.Nr.704/19 me të cilën aprovon ankesën e O.E “Comet” Sh.p.k si të bazuar dhe Obligon Autoritetin Kontraktues-Komuna e Mamushës që të zbatojë vendimin PSH nr. 491/19 të datës.23.09.2019. Komuna e Mamushës e kthen lëndën në rivlerësim dhe e shpërblen O.E “Comet” sh.p.k me kontratë. Dhe me pas e anulon tenderin me arsyetimin se ka kaluar afati i zotimit të mjeteve pasi që projekti në fjalë ka qenë i paraparë të realizohet gjate vitit fiskal 2019. Pas anulimit të tenderit në fjalë O.E “Comet” Sh.P.K ka paraqitur përsëri kërkesë për rishqyrtim të vendimit të cilën Komuna Mamushës i’a ka refuzuar si të pa bazuar me vendimin 02 nr. 10-20 të datës 21.01.2020. I pakënaqur me këtë vendim Operatorit Ekonomik me datë 21.01.2020, ka parashtruar ankesë në OSHP me nr.57/20. OSHP-ja, përsëri ka caktuar ekspertin shqyrtues i cili me datë 06.02.2020 ka dërguar raportin e ekspertizës dhe ka kërkuar që ankesa e operatorit ekonomik të aprovohet si e bazuar dhe rekomandon autoritetin kontraktues të vazhdojë me*

lidhjen e kontratës. Autoriteti kontraktues-Komuna e Mamushës me vendimin 02.nr.25-20 të datës 10.02.2020 ka kundërshtuar mendimin e ekspertit shqyrtues. Pas këtij kundërshtimi OSHP-ja me datë 11.03.2020, ka nxjerrë vendimin PSH.nr.57/20 me të cilin ka aprovuar si të bazuar ankesën e O.E “Comet” SH.P.K dhe u ka shqiptuar gjobë Autoritetit Kontraktues në shumën prej 5.000 Euro për mos zbatim të urdhëresës së panelit shqyrtues me nr. të protokollit P.SH nr.704/19 të datës 17.12.2019. I pakënaqur me këtë vendim, paditësi ka ushtruar padi në këtë gjykatë me datë: 27.10.2017, duke e kontestuar ligjshmërinë e tij. Gjykata konstatoi se, procedura e prokurimit është zhvilluar në pajtim me nenin 105 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik, i cili ndër të tjera, në paragrafin 2.12 përcakton se: OSHP-ja ka kompetenca, autoritet, pushtet dhe përgjegjësi, në kuadër të kushteve të saktësuara: “të lëshojnë një urdhër me të cilin detyrohen zyrtarët për zbatimin e ligjit që të ndihmojnë OSHP-në në ekzekutimin e një urdhri të OSHP-së. Gjykata gjeti se, vlerësimet e të paditurës kanë qenë të drejta kur, në bazë të provave të ofruara nga “Comet” SH,P.K , e njëjta i ka plotësuar kushtet e parapara për tenderin, dhe atë në lidhje me faktin se ka qenë i përgjegjshëm dhe në rregull sa i përket specifikacioneve teknike duke i plotësuar kërkesat minimale të dosjës së tenderit është në përputhje me nenin 72 të LPP-së, i cili thekson: “Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenin 65-71 të këtij ligji”, dhe sipas nenit 59 të LPP-së, ku ndër të tjerë, në paragrafin 4 thuhet: “Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”, rrjedhimisht, e paditura drejtë ka vlerësuar se me kërkesën për qartësim, dhe me veprimet e “Comet” SHPK, duke ofruar dëshmi dhe sqarime sipas kësaj kërkesë, nuk është cënuar dispozita e lartcekur. Në këtë kuptim, e paditura drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe bazën ligjore. Andaj përkundër pretendimeve të paditësit, gjykata nuk ka administruar prova që do të dëshmonin se personat zyrtarë të përfshirë në këtë proces kanë vepruar në kundërshtim me këto dispozita. Gjykata konstatoi se, në procedurën e ankimimit, OSHP-ja si e paditur, ka vepruar në mënyrë efikase, të shpejtë, të drejtë, dhe duke mos diskriminuar asnjërin palë, dhe ka zbatuar masat proporcionale në lidhje me shkeljet apo lëshimet e bëra në procedurë, duke pasur parasysh edhe interesin publik dhe natyrën e aktivitetit, e kjo në kuptim të nenit 104 të LPP-së, ku ndër të tjera, paragrafi 2 thotë: “Zbatimi i ndonjë procedure të shqyrtimit dhe asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret ose bëhet në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një pjesëmarrësi në procedurë ose të një personi ose ndërmarrje tjetër”, dhe paragrafi 4, i cili thotë: “Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara në këtë pjesë IX, OSHP duhet (i) të veprojë sa më shpejtë që të jetë e mundshme, (ii) të veprojë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe (iii) të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik”, dhe ka vepruar në pajtim me nenin 105 të LPP-së, rrjedhimisht në pajtim me nenin 106 të këtij ligji. Pretendimet e paditëses se gjatë procedurës është diskriminuar, dhe se janë shkelur dispozitat e lartcekura nuk janë të dëshmuara me fakte apo prova, rrjedhimisht janë të pabazuara. Duke shqyrtuar pretendimet e paditësit, gjykata gjeti se, pretendimet nuk janë të bazuara mbi dispozitat e këtyre neneve dhe, nuk është provuar me prova nga paditësi, në kuptimin që lëshimet eventuale gjatë zhvillimit të procedurave, kanë ndikuar që njëra palë të favorizohet apo diskriminohet. Në këtë kuptim, gjykata konstatoi se, nuk është provuar nga paditësja se për shkak të vendimit të atakuar,

të njëjtës i është shkaktuar dëm, bazuar në dispozitat e lartcekura. Andaj, gjykata duke vlerësuar pretendimet e paditësit, të dhëna në padi dhe në fjalën e saj në procedurë para gjykatës, të njëjtat pretendime i refuzoi si të pabazuara, nga arsyeja se paditësi të njëjtat nuk i ka provuar me fakte dhe prova të cilat do të kishin ndikuar që kjo gjykatë të mund të vërtetoj një tjetër gjendje faktike nga ajo që ka vërtetuar organi i paditur. Prandaj, gjykata vlerëson se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e paditura, drejtë ka zbatuar dispozitat e procedurës administrative, drejtë ka zbatuar ligjin material, kur ka aprovuar pjesërisht ankesën e paditëses dhe ka vërtetuar njoftimin për anulim të aktivitetit të prokurimit.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, se “*Me aktgjykimin ankimor është bërë shkelje e nenit 183 të LPK-së duke vërtetuar gabimisht gjendjen faktike për sa i përket zbatimit të vendimit të OSHP-së, cilësimit të ofertës së operatorit ekonomik ankues si të përgjithshme edhe përkundër që nuk i ka plotësuar kërkesat e autoritetit kontraktues (deklaratën për specifika teknike) si dhe sa i përket kohës së nxjerrjes së vendimit nga ana e OSHP-së për shkak të neglizhencës së tyre, vendimi është marrë me vonesë e cila ka ndikuar në mos realizimin e projektit. Konstatimi i gabuar i gjendjes faktike ka bërë që vendimi gjyqësor të jetë refuzues për palën paditëse, pasi që ka vepruar në kundërshtim me vet përmbajtjen e dokumenteve të cilat i ka administruar si prova ” Mirëpo kolegji i apelit të njëjtin pretendim e vlerëson si të pa bazuar për faktin se gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, ngase në mënyrë të pa kontestuar është vërtetuar gjendja faktike, kjo për faktin se bazuar në shkresat e lëndës, vërtetohet me të drejtë nga Gjykata e shkallës së parë se procedura e prokurimit është zhvilluar në pajtim me nenin 105 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, dhe vlerësimet e të paditurit kanë qenë të drejta kur ka vlerësuar se operatori ekonomik “Comet” SH.P.K, i ka plotësuar kushtet e parapara për tenderin, dhe atë në lidhje me faktin se ka qene i përgjegjshëm dhe në rregull sa i përket specifikacioneve teknike duke i plotësuar kërkesat minimale të dosjes së tenderit është në përputhje me nenit 72 të LPP-së. Në bazë të shkresave të lëndës, po ashtu, vërtetohet se në procedurën e ankimit, OSHP-ja si e paditur, ka vepruar në mënyrë efikase, të shpejtë, të drejtë, dhe duke mos diskriminuar asnjërin palë, dhe ka zbatuar masat proporcionale në lidhje me shkeljet apo lëshimet e bëra në procedurë, duke pasur parasysh edhe interesin publik dhe natyrën e aktivitetit, dhe rrjedhimisht nga kjo, edhe vendimi i kundërshtuar, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.*

Prandaj, për këto arsye kolegji i apelit vlerëson se janë të pa bazuara pretendimet ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, pasi që paditësja me asnjë provë nuk i ka vërtetuar pretendimet e saj ankimore, ndërsa provat e prezantuara nuk janë me ndikim për vendosje ndryshe të kësaj çështje administrative juridike.

Gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu vendimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale, respektivisht nenin 59, 72, 104 dhe 105 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik.

Mbi këto arsye kolegji i apelit këto pretendime ankimore i konsideron si të pa bazuara, prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke vlerësuar se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditëses, dhe mbi këtë bazë ankesa e paditëses u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.525/2023, datë;13.05.2024

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti